

URDHËR
Nr. 619, datë 16.10.2025

**PËR AUTORIZIMIN DHE DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE/AUTORITETIT
TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, ZËVENDËSMINISTRIT TË DREJTËSISË, ZNJ.
ELONA HOXHA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Znj. Elona Hoxha, gjatë ushtrimit të funksionit si zëvendësministër i Drejtësisë, zbaton dhe mban përgjegjësi për detyrat që i caktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

2. Zëvendësministri i Drejtësisë përgjigjet para ministrit të Drejtësisë për ecurinë dhe efektivitetin e reformës në drejtësi, nivelin e realizimit të reformave të ndërmarra në institucionet penitenciare dhe institucionet në varësi të ministrit të Drejtësisë, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë dhe të legjislacionit në fuqi, mirëfunksionimin e profesioneve të lira nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe koordinon punën në fushën e marrëdhënieve juridiksioneve me shtetet e tjera.

3. Zëvendësministri i Drejtësisë monitoron dhe mbikëqyr punën për realizimin dhe jetësimin e të gjitha aspekteve të reformës në drejtësi, përfshirë këtu, edhe ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor në fuqi dhe zbatimin e hartës gjyqësore të miratuar në bashkëpunim me institucionet e sistemit të drejtësisë dhe misionet e asistencës teknike në këtë fushë.

4. Në kuadër të realizimit të reformave të ndërmarrë në institucionet penitenciare dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, zëvendësministri i Drejtësisë monitoron dhe mbikëqyr mbarëvajtjen e punës në drejtim të hartimit, zbatimit dhe/ose ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore të paketës penitenciare dhe zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës, zhvillimit të programeve të punësimit për të dënuarit me burgim, zbatimit efektiv të strategjisë së drejtësisë për të mitur dhe mirëfunksionimit të Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe ofrimit të ndihmës juridike falas në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat jofitimprurëse.

5. Zëvendësministri i Drejtësisë mbikëqyr mbarëvajtjen e punës në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e tjera, si dhe me urdhër të ministrit të Drejtësisë, merr pjesë në negociatat për lidhjen e marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe me shtetet e tjera.

6. Për zbatimin e detyrave të mësipërme znj. Elona Hoxha, i delegohen kompetencat dhe autoriteti i titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, si më poshtë:

a) lëshimi i autorizimeve për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë në emër të nëpunësit/nëpunësve që përfaqësojnë Ministrinë e Drejtësisë;

b) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e të gjitha letërporosive për jashtë shtetit dhe nga jashtë shtetit që i përkasin juridiksionit të përgjithshëm civil;

c) kërkesave për informacion nga persona fizik ose juridik privat, në lidhje me çështjet e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë në fushën civile dhe penale;

ç) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave për mbajtjen e korrespondencës me shtetas shqiptarë e të huaj, të afërm, si dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre mbi problematikat e transferimeve, kërkesave për ndihmë juridike, ekstradime etj., lidhur me shtetasit shqiptarë që vuajnë dënimin jashtë vendit, apo shtetas të huaj, që vuajnë dënimin në Republikën e Shqipërisë;

d) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave për mbajtjen e korrespondencave për kërkesat për zbatimin e ligjshmërisë dhe trajtimin e ankesave të institucioneve shtetërore, bizneseve dhe qytetarëve mbi zbatimin e ligjshmërisë në fushën e drejtësisë nga gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë në fushën penale dhe civile;

dh) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave për mbajtjen e korrespondencave të ndryshme dhe kthimin e përgjigjeve për ankesa dhe kërkesa nga persona juridikë, fizikë, publikë dhe privatë, në lidhje me zbatimin e ligjit nga personat që ushtrojnë profesionet e lira nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, me përjashtim të atyre për të cilat legjislacioni në fuqi ka parashikuar shprehimisht nënshkrimin nga ana e ministrit të Drejtësisë;

e) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë, të kontratave të punës të punonjësve me kontratë të përkohshme, të punonjësve të punësuar sipas Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, si dhe studentëve të ekselencës të punësuar pranë Ministrisë së Drejtësisë;

ë) kompetencat e titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për nënshkrimin e shkresave për kthim përgjigje, në lidhje me kërkesat për pajisje me kopje të dokumentacioneve arkivore.

7. Kostot financiare për ushtrimin e kompetencave të parashikuara në këtë urdhër nga zëvendësministri i Drejtësisë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Ushtrimi i kompetencave të deleguara sipas këtij urdhri, fillon nga data e hyrjes në fuqi e tij dhe përfundon me:

a) shfuqizimin e këtij urdhri; ose

b) përfundimin e ushtrimit të funksioneve të zëvendësministrit të Drejtësisë nga znj. Elona Hoxha.

9. Urdhri nr. 54, datë 6.2.2024, i ministrit të Drejtësisë, “Për autorizimin dhe delegimin e disa kompetencave/autoritetit të ministrit të Drejtësisë zëvendësministrit të Drejtësisë z. Klajd Karameta”, shfuqizohet.

10. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Besfort Lamallari